



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 88

Prishtinë, më 22.7.2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Ardian Gjini, Mufera Shinik, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Gëzim Kelmendi.

Munguan: Arsim Bajrami, Haki Demolli dhe Sreten Ivanoviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hava Orana dhe Mimoza Leka – gazeta "Bota Sot", Alma Lama – deputete, Lejla Selimi – OSBE, Saranda Rama – gazeta "Zëri", Sylë Ahmeti – gazeta "Kosova sot", Bajram Gecaj, Trens Harold dhe R.M – USEB, Artan Canhasi dhe Vlora Marmullakaj – EULEX, Erëlehta Popaj – Kosova Live, Donik Shala – MD, Ardian Bajraktari – MD, Petrit Hysaj – OSBE, Gurjeta Zeka, Rebeka Maliqi, Gjylferije Zabeli, Avni Tusha – praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.6.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në pikën të ndryshme, të shqyrtohet edhe Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Behar Selimi – Propozoi që në kuadër të rendit të ditës, të futet pakoja e ligjeve për integritet evropiane, që ne sot t'i japim pëlqimin këtyre ligjeve që mos të dalim pastaj në situata të pa-

përshtatshme në Kuvend. Është folur mjaft për këto ligje. Këto ligje janë përkrahur dhe kanë qenë edhe nën llupën e BE-së. Mendoj se jemi vonuar mjaft dhe propozoj që ky ligj të futet në rend të ditës.

Armend Zemaj – Tash jemi vetëm në çështje procedurale, dhe nëse mendimi i Komisionit Funkcional raportohet se është arritur, atëherë kishim mundur t'i fusim edhe në rend dite, përndryshe pa dokumentacion përkatës, nuk e di se si mund të veprojmë. Kjo është vetëm procedurë.

Kryetari– Mua po më duket pak e çuditshme që 8 ligje të kalohen, pa pasur asnjë material.

Ardian Gjini – Parimisht, nuk kam asgjë kundër, nëse komisionet do t'i kishin sjellë raportet e tyre, por nuk kemi asnjë raport.

Halit Krasniqi– Unë do ta mbështesë propozimin e z.Selimi.

Albulena Haxhiu – Jam kundër, për shkak se nuk kemi material paraprakisht dhe dokumentet përkatëse nga komisionet funksionale. Po ashtu, kundërshtoj edhe procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjeve në Kuvend, meqë me këtë procedurë po degradon Kuvendi, sepse këto projektligje janë shumë të rëndësishme dhe duhet të analizohen nga secili komision, në bazë të përgjegjësive përkatëse.

Komisioni nuk e përkrahu propozimin e deputetit Behar Selimi.

Kryetari konstatoi se e rendi ditës miratohet me ndryshimet e propozuara, që në pikën të ndryshme, të shqyrtohet edhe Projektligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.6. 2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.6. 2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Kryetari – Ju e dini se ky projektligj ka kaluar në seancë, në parim, pa kaluar në Komision, dhe ata duhet ta dinë se si ta procedojnë më tutje, ngase unë nuk e kam përkrahur as në seancë dhe as këtu nuk do ta përkrah.

Behar Selimi – Unë e përkrahu, ngase na është thënë publikisht se ky projektligj është pjesë e pakos së integritetit dhe e kemi futur me procedurë të shpejtë.

Albulena Haxhiu – Ashtu siç e kam thënë edhe më herët, në nenet e këtij projektligji ka shumë paqartësi dhe kundërthënie edhe mes neneve, si dhe lë hapësirë të shumtë interpretimi, andaj propozoj që ta formojmë një grup punues dhe të merremi në mënyrë intensive me këtë projektligj.

Armend Zemaj– Në këtë projektligj kemi punuar dhe është mjaft i freskët për ne. Mendoj se kemi arritur t'i bëjmë disa ndryshime përmbajtësore dhe se është më i mirë sesa versioni i herës së kaluar. Për shkak të situatës në të cilën gjendemi, mund edhe të merret vendim politik, mirëpo unë e kam një

vërejtje tek neni 104, që e theksoi edhe Albulena për çështjen e interpretimit. Mirëpo, për nga përmbajtja, është diçka më mirë se ligji që është tash në fuqi, por propozoj që të amendamentohet.

Kryetari– Duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Behar Selimi, tha se çështja është shumë e thjeshtë, nëse arrin t’i bindësh antarët e Komisionit për propozimin tënd, ngase kjo është demokraci dhe me shumicë votash mund ta fuqizosh propozimin. Mirëpo, mendoj se nuk është në rregull të votohet diçka që nuk është trajtuar seriozisht.

Aremnd Zemaj – Shprehu vullnetin që të jem anëtar i grupit punues, dhe pastaj që të trajtohet dhe amendamentohet. Ne kemi praktika edhe kur kemi dashur të trajtojmë një ligj në mënyrë të specifikuar, në kuadër të grupeve punuese, prandaj jam për atë që kjo mënyrë e punës duhet të ndërrohet.

Behar Selimi– Kërkoi nga kryetari që të hidhet në votim propozimi i tij, që projektligji të kalojë pa asnjë ndryshim.

Kryetari, fillimisht, *hodhi në votim propozimin e deputetes Albulena Haxhiu, për themelimin e grupit punus, i cili me 3 vota për dhe 4 kundër, nuk u përkrah.*

Në momentin e votimit, prezent ishin 7 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota për dhe 3 kundër, e përkrahu propozimin e deputetit Behar Selimi dhe vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit, komisioneve kryesore dhe deputetëve t’ua paraqesë këtë

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe miratohet Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, pa amendamente.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor

Kryetari – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit Funkcional, në Projektligjin nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t’i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve

Kryetari – I njoftoi me përmbajtjen e projektligjit, e që është nismë e deputetes Alma Lama, i cili është trajtuar në komisionet tjera. Ai kërkoi nga anëtarët që të paraqesin vërejtjet, nëse kanë.

Albulena Haxhiu– Tha se ky projektligj duhet të kalojë, pasi që ka kaluar të gjitha procedurat e rregullta dhe i plotëson kushtet për miratim.

Alma Lama– Në cilësi të propozuesit të këtij projektligji, tha se ky projektligj është dorëzuar vitin e kaluar dhe deri më tani ka qenë në procedim. Jam e gatshme që të jap sqarime shtesë për çfarëdolloj paqartësie. Ky projektligj është edhe kontribut i bashkëpunimit me mediat dhe çfarëdo ligji që të sillet, lë hapsirë për keqpërdorim, mirëpo është më mirë ta kemi këtë ligj.

Armend Zemaj – Personalisht, e përshëndes iniciativën dhe është një shenjë e mirë edhe për Kuvendin, edhe për ne deputetët. Kjo fushë, edhe pse mbulohet me Kodin penal, unë nuk jam kundër që të kemi një ligj i cili rregullon këtë çështje në mënyrë specifike. Unë e jap votën “për” dhe jam për lirinë e mediave, pra për lirinë profesionale të mediave.

Behar Selimi – Mendoj se komisionet tjera kanë kryer punën e tyre dhe se unë personalisht mendoj se duhet ta mbështesim këtë projektligj dhe ta kalojmë më tutje.

Në momentin e votimit, prezent ishin 6 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 5 vota për dhe 1 votë kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

3. Projektligji nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
4. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t’i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

b. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetari– Në aspektin teknik, amandamentet e propozuara, i plotësojnë kushtet formale-juridike, kurse sa i përket aspektit politik, le të vendoset ne seancë. Në parim, jam kundër dhe nuk do ta votoj projektligjin që e ka sjellë Qeveria.

Albulena Haxhiu – Në nenin 2 të këtij projektligji, ka kundërthënë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky nen paraqet formimin e Fondit Zhvillimor për Veriun, e që bie ndesh me nenin 17, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në momentin e votimit, prezent ishin 7 deputetë.

Kryetari Konstatoi se Komisioni me 4 vota për dhe 3 kundër, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, nuk është në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi